



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 48 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 02 / 2025

VENDIM
Nr.07, date 27 /02 /2025

NË LIDHJE ME TË DHËNAT E MONITORIMIT HIDROMETEOROLOGJIK DHE SISTEMET E ALARMIT PËR DIGAT E MËDHA TË ADMINISTRUARA NGA MINISTERIA E BUJQËSISË DHE E ZHVILLIMIT RURAL (MBZHR)

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim problematikat e evidentuara në lidhje me monitorimin e digave të ujitjes që administrohen nga MBZHR dhe në mënyre të vecantë në lidhje me sistemet e alarmit, të dhënat e monitorimit hidrometeorologjik si dhe matjet e volumeve aktuale të ujit në rezervuarët e krijuar nga digat që janë në administrim të MBZHR. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM.

VENDOSI:

- 1- **Ti kërkoj Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe bordeve të Ujitjes prane kesaj Ministrie te pregatitin plan masash ne lidhje me instalimin e sistemeve te alarmit, instalimin e sistemeve te monitorimit ne digat e medha qe administrohen nga MBZHR, brenda muajit Maj 2025. Ne kete plan masash duhet te perfshihen te gjitha masat qe duhet te merren ne lidhje me instalimin e sistemeve te alarmit, instalimin e sistemeve te monitorimit si dhe me masat per zhvillimin e procesit te monitorimit te digave me instrumenta sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi**
- 2- **Ti kërkoj MBZHR kryerjen e matjeve të volumeve faktike të ujit në të gjithë rezervuarët e ujit të krijuar nga digat e mëdha që administrohen nga MBZHR në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.**

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit të këtij Vendimi dhe të pregatit brenda muajit Qershor 2025 një informacion të detajuar në lidhje me plotësimin e detyrave të mësipërme.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI